

# Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës

Rekomandime për një partneritet  
të suksesshëm Shkollë-Familje-Komunitet

TETOR 2011

REKOMANDIME PËR RRITJEN E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË ARSIM  
FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

# **Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës**

**Rekomandime për një partneritet të suksesshëm  
Shkollë-Familje-Komunitet**

MA FATMIR BEZATI  
MA ROZETA HOXHALLARI

# Hyrje

Ky raport i shkurtër është përgatitur duke u mbështetur në gjetjet dhe përfundimet e një studimi kombëtar të pikëpamjeve, qëndrimit dhe praktikave të drejtorëve të shkollave dhe prindërve në lidhje me përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunimin shkollë-familje, i cili u realizua me ndihmën e Programit të Mbështetjes së Arsimit të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur në kuadër të projektit të Përparimit të Cilësisë së Arsimit dhe Përfshirjes në Evropën Jug-lindore.

Pas një analize të thellë të rezultateve të studimit, të situatës aktuale dhe të studimeve shkencore në lidhje me temën, nëpërmjet këtij dokumenti ofrohet informacion thelbësor në lidhje me rëndësinë e madhe dhe mënyrat efektive të përfshirjes së prindërve në arsimimin e fëmijëve të tyre. Gjithashtu janë formuluar një numër rekomandimesh në nivelin e politikëbërjes, shkollës dhe komunitetit për rritjen e përfshirjes së prindërve nëpërmjet krijimit dhe forcimit të bashkëpunimit dhe partneritetit shkollë-familje-komunitet. Këto rekomandime u vijnë në ndihmë mësuesve, drejtorive të shkollave, insitucioneve arsimore lokale, rajonale dhe kombëtare si edhe organizatave dhe individëve të interesuar për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe rezultateve të nxënësve.

## Analiza e situatës dhe studimi i literaturës

Studimet shkencore gjatë tri dekadave të fundit kanë vërtetuar se përfshirja e prindërve është mjaft e rëndësishme në procesin e të mësuarit të fëmijëve, në mendimin e tyre për shkollën dhe në aspiratat e tyre. Fëmijët janë nxënës më të suksesshëm përgjatë gjithë shkollës nëse prindërit e tyre përfshihen në shkollë dhe inkurajojnë të mësuarit në shtëpi, pavarësisht nga niveli arsimor apo shoqëror i tyre (Epstein, 2001).

Gjithashtu, sipas kërkimeve shkencore, programet e bashkëpunimit dhe partneritetit shkollë-familje-komunitet dhe praktikatat e mësuesve në lidhje me përfshirjen e prindërve kanë efekte mjaft pozitive në aftësitë e prindërve për t'i ndihmuar fëmijët e tyre përgjatë viteve të shkollës; në vlerësimin e prindërve për aftësitë e mësuesve dhe cilësinë e mësimdhënies; në opinionin e mësuesve për mundësitë e prindërve për të ndihmuar fëmijët e tyre me detyrat e shkollës në shtëpi dhe në mendimin e nxënësve për shkollën... (Becker & Epstein, 1982; Epstein 2001).

Partneriteti shkollë-familje-komunitet përmirëson programet shkollore dhe klimën në shkollë, ofron shërbime dhe mbështetje për familjet, rrit aftësitë e prindërve dhe rolin drejtues të tyre, krijon lidhje midis prindërve në shkollë dhe komunitet dhe ndihmon mësuesit në punën e tyre. Mbi të gjitha, partneritete të tilla krijohen për të ndihmuar të rinjtë të kenë sukses në shkollë dhe në jetë. (Epstein, 2001)

Në Shqipëri janë ndërmarrë një sërë inisiativash dhe reformash, të cilat janë shoqëruar me dispozita ligjore. Gjithashtu, bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimit të arsimit është ndërthurur në Strategjinë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar (SKAP)(2009-2013) si një komponent i qënësishëm i procesit të decentralizimit.

Pavarësisht nga zhvillimet pozitive, niveli i përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës dhe i bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet është ende shumë i dobët. Në SKAP (2009-2013) theksohet ecuria jo e kënaqshme e decentralizimit të përgjegjësive dhe autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror në atë lokal kryesisht si rrjedhojë e mungesës së një lidhjeje të plotë e funksionale midis shkollës dhe komunitetit dhe mungesës së mbështetjes në fuqinë e familjes dhe në karakterin social të komunitetit për suksesin në arsim.

Për të analizuar shkaqet kryesore të hendekut midis synimeve të reformave dhe nivelit aktual të përfshirjes së prindërve dhe bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet, studimi i kryer në kuadër të projektit të Përparimit të Cilësisë së Arsimit dhe Përfshirjes u përqëndrua në pikëpamjet, qëndrimet dhe praktikat e prindërve dhe drejtorëve të shkollave në këtë aspekt.

Rezultatet e studimit tregojnë se pavarësisht se përfshirja e prindërve në përgjithësi konsiderohet si e rëndësishme, pranohet fakti që shkollat nuk kanë një program efikas bashkëpunimi/partneriteti që siguron përfshirjen e të gjithë prindërve. Prindërit e përfaqësuar në strukturat e shkollës janë më të përfshirë se prindërit e tjerë, ndonëse në një numër dhe spektër të kufizuar aktiviteteve. Ndërsa prindërit e zakonshëm dhe veçanërisht ata Romë ftohen rrallë nga shkolla dhe ndihen të paafte për t'i ndihmuar fëmijët e tyre dhe shkollën.

Studime të ndryshme shkencore theksojnë se nuk duhet të pritët që prindërit të krijojnë vetë njohuritë e duhura për të ndihmuar fëmijët e tyre si nxënës, ose për të kontaktuar me shkollën/mësuesit, por se duhet të jetë shkolla që informon dhe përfshin prindërit nëpërmjet programeve të partneritetit shkollë-familje-komunitet.

Ndër vite, në bazë të kërkimeve shkencore, është krijuar një sistem prej gjashtë rrugësh kryesore të përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës<sup>1</sup>. Ato përmbajnë aktivitete që mund të organizohen në shkollë, në shtëpi dhe në komunitet nga mësuesit, nxënësit, prindërit, drejtuesit dhe aktorë të tjerë për përmirësimin e shkollave, forcimin e familjeve dhe rritjen e suksesit të nxënësve. (Epstein 2001).

Mësuesit luajnë rol vendimtar në përfshirjen e prindërve në shkollë. Në studimin e tyre (1989), Epstein dhe Douber kanë zbuluar se mësuesit që kanë pikëpamje më pozitive ndaj përfshirjes së prindërve, i kushtojnë më tepër rëndësi nga të tjerët praktikave të tilla si organizimi i takimeve me prindërit e të gjithë nxënësve për programet shkollore dhe shkëmbimi me prindërit si i rezultateve negative, ashtu edhe atyre pozitive të nxënësve të tyre. Forcimi i qëndrimeve pozitive të mësuesve gjithashtu korrelohet me rritjen e suksesit në përfshirjen e prindërve “të vështirë për t’u arritur”.

Kur mësuesit e bëjnë përfshirjen e prindërve pjesë të praktikave të përditshme të mësimdhënies, prindërit rrisin bashkëveprimin me fëmijët e tyre në shtëpi, kanë ndjesi më pozitive për aftësitë e tyre për t’i ndihmuar fëmijët e tyre, kanë vlerësim më të lartë për mësuesit në përgjithësi dhe nxënësit përmirësojnë qëndrimin dhe arritjet e tyre (Epstein, 2001).

<sup>1</sup> Prindërimi, Komunikimi, Vullnetarizmi, Të mësuarit në shtëpi, Vendimmarrja dhe Bashkëpunimi me Komunitetin

# Objektivat dhe metodologjia e studimit

## Objektivi kryesor i studimit

Zbulimi i opinionit dhe qëndrimeve të prindërve dhe drejtuesve të shkollave lidhur me bashkëpunimin prindër-shkollë si dhe i shkollës së përfshirjes së prindërve në jetën e shkollës.

## Metodologjia

Ky dokument është hartuar mbi të dhënat e dy sondazheve.

**Sondazhi i parë** në shkallë kombëtare me drejtorët e shkollave. Të dhënat e këtij sondazhi u mblodhën duke përdorur metodën e kampionimit rastësor në dy faza. Në fazën e parë u identifikua shpërndarja sipas rajoneve e shtresave përkatëse. Ndërsa në fazën e dytë u zbatua kampionimi i rastit. Shkollat gjithashtu u përzgjedhën bazuar në shpërndarjen urbane/rurale.

**Sondazhi i dytë** në shkallë kombëtare me prindër. Në fazën e parë u bë shqyrtimi dhe rishikimi i kontekstit në Shqipëri në lidhje me pjesëmarrjen e prindërve si dhe legjislacionin që e rregullon atë, gjithashtu dhe organizimi i disa fokus grupeve me prindër të grupeve të ndryshme, prindër nga grupi i shumicës dhe prindër nga grupet vulnerabël. Në fazën e dytë u zbatua kampionimi rastësor.

## Kampioni për të dy sondazhet

Popullata e studimit përbëhet nga prindër të nxënësve të shkollës fillore, prindër anëtarë të bordeve të shkollës ose të këshillave të prindërve në të njëjtën shkollë apo prindër anëtarë të shoqatës prind-mësues, prindër Rom dhe drejtorë shkollash.

Lloji i kampionimit ishte kampionim i rastësishëm i shtresëzuar. Madhësia e kampionit paraqitet si më poshtë:

- 300 drejtorë shkollash (N=300), që përfaqësojnë 20% të drejtorëve në shkallë vendi.
- 1123 prindër gjithsej (N=1123), nga këta dy kampione me nga 30 prindër të përjashtuar nga ana sociale në dy shkolla (N=60).

Studimi u realizua përgjatë periudhës 2008 – 2009.

# Gjetjet kryesore

## Prindërit

- Ka një lidhje domethënëse ndërmjet rezultateve të fëmijës në shkollë dhe faktit nëse prindërit e tyre janë të përfshirë ose jo në jetën e shkollës.
- Prindërit që përfshihen në jetën e shkollës kanë shpresa dhe aspirata më të larta për arsimimin e fëmijëve të tyre dhe presin që fëmija të arsimohet në universitet. Ndërkohë, pjesa më e madhe e prindërve të përjashtuar nga ana sociale janë të prirur drejt dhënies së një zanati për fëmijën e tyre. Gati një e treta e këtyre prindërve mendojnë se fëmija e tyre do të përmbushë vetëm arsimin e detyrueshëm.
- Pothuajse gjysma e prindërve Romë deklarojnë se ftesa për takimet me prindër ka ardhur 3 ose më pak herë gjatë vitit të fundit.
- 25% e fëmijëve Romë nuk marrin ndihmë nga askush për detyrat e shtëpisë. Është interesante që 27% e fëmijëve Romë ndihmohen për detyrat nga dikush tjetër që nuk është prindi i tyre. Baballarët Romë nuk përfshihen aspak në ndihmën për detyrat e shtëpisë.
- Prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës rezultojnë të ftuar më shpesh sesa prindërit e tjerë për të ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës së shkollës. 60% e prindërve Romë nuk janë ftuar asnjëherë për të ndihmuar në këtë drejtim, kundrejt 31% të prindërve që i përkasin shumicës së popullsisë.
- Më shumë se gjysmës së të gjithë prindërve në kampion nuk i është kërkuar kurrë mendim në lidhje me menaxhimin e fondeve të shkollës.
- Të pyetur nëse shkolla ka marrë parasysh opinionin e tyre si prindër për organizimin e aktiviteteve një pjesë e prindërve të zakonshëm (44%) dhe një pjesë e prindërve të përjashtuar nga ana sociale (45%) thonë se kjo nuk ka ndodhur kurrë.
- 60% e prindërve Romë thonë se nuk iu është kërkuar asnjëherë në tre vitet e fundit që të bëhen pjesë e këshillit të klasës ose të shkollës, ndërkohë që 37% e tyre thonë se ju është kërkuar vetëm një herë të jenë pjesë e këshillit të klasës.
- Pjesa dërrmuese e prindërve Romë mendojnë se nuk janë të aftë për të përmbushur rolin e përfaqësuesit në strukturat e shkollës.

- Vetëm 26% e prindërve Romë mendojnë se sjellja e mësuesve paraqet respekt ndaj tyre, krahasuar me 40% të prindërve të tjerë që ndajnë të njëjtin mendim.
- 88% e prindërve përfaqësues mendojnë se administrata e shkollës nuk është e interesuar për kontributin e tyre dhe se ata përdoren nga administrata e shkollës sa për të mbështetur idetë e tyre.

## Drejtorët e shkollave

- Sipas studimit pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave (72.6 %) organizojnë takime me prindër të paktën një herë në tre muaj dhe 41.5 % i organizojnë ato të paktën një herë në muaj.
- Drejtorët e shkollave pohojnë se në 62 % të rasteve ndajnë me prindërit informacion mbi veprimtaritë e shkollës, i cili dërgohet një herë në tre muaj.
- Aspekte të tjera si për shembull, informacioni mbi kurrikulën, informimi mbi politikat e shkollës, u përcillen prindërve më rrallë.
- Çështja më e diskutuar në takimet në shkollë është disiplina/sjellja (41.6 % e rasteve) ndjekur nga notat/suksesi (38.2 %).
- Në rreth 20 % të rasteve shkollat organizojnë të paktën një herë në muaj takime me qëllim aftësimin e prindërve për ndihmën që ata mund t'u japin fëmijëve të tyre kundrejt përgatitjes së detyrave të shtëpisë. Në 39 % të rasteve këto takime organizohen të paktën një herë në semestër. Ndërsa në 41.1 % të rasteve takime të tilla realizohen një herë në vit ose aspak.
- 43.2 % e drejtorëve të shkollave mendojnë se prindërit kanë një farë ndikimi mbi vendimet e marra në nivel klase. 40.3 % e tyre mendojnë se prindërit kanë ndikim mbi vendimet e marra në nivel shkolle dhe 34 për qind e tyre mendojnë se prindërit ndikojnë në politikat në nivel shkolle.
- 31 % e drejtuesve të shkollave mendojnë se prindërit kanë ndikim të ndjeshëm në procesin e vlerësimit të performancës së mësuesve.
- Sipas pohimit të pjesës më të madhe të drejtorëve të shkollave (60.2 %), anëtarët e Këshillit të Prindërve kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet ku merren vendime në nivel shkolle pa kufizime.
- Rreth 40 % e drejtorëve të shkollave mendojnë se prindërit kanë të drejtë të marrin pjesë në këto mbledhje vetëm me ftesë.

# Rekomandimet

## I. Në nivelin kombëtar të politikëbërjes

- MASH në bashkëpunim me institucionet e specializuara duhet të zhvillojë trainime të mirëorgaizuara për të gjithë drejtorët e shkollave dhe stafin pedagogjik mbi rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe metodat efektive të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet.
- Shkollat duhet të kenë mbështetje të veçantë teknike e financiare nga MASH dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit për zhvillimin e programeve të suksesshëm të bashkëpunimit/partneritetit shkollë-familje-komunitet. Meqenëse këto programe janë një komponent i rëndësishëm i reformës kurrikulare dhe mësimdhënies, aspekte të tyre mund të mbështeten nga fondet për zbatimin e reformës në kurrikulë e mësimdhënie
- MASH së bashku me Fakultetet e Pedagogjisë duhet të inkurajojnë zhvillimin e një lënde të veçantë në programin universitar për përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet.
- Duke konsideruar rolin përcaktues të mësuesve në përfshirjen e prindërve në shkollë, është e rëndësishme të kryhet një studim në nivel kombëtar i njohurive, pikëpamjeve dhe praktikave të tyre në lidhje me përfshirjen e prindërve. Rezultatet e tij do të ndihmonin në hartimin e programeve të trainimit të mësuesve në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.
- Puna me prindër duhet të jetë një ndër kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesve dhe të drejtuesve të shkollës.
- Nevojiten përmirësime ligjore për të siguruar një bashkëpunim më të mirë me prindërit por në cdo rast ato duhet të mbështeten në programe të qëndrueshme aftësimi të aktorëve kryesor.

## II. Në nivel shkolle

- Drejtorët e shkollave duhet të investojnë në trainimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve në lidhje me përfshirjen e prindërve dhe t'u ofrojnë atyre mbështetje në përpjekjet dhe iniciativat e tyre.



- Përfshirja e prindërve nuk mund të jetë e suksesshme nëse bazohet në nisma dhe praktika sporadike individuale të mësuesve. Ajo duhet të bazohet në një program të plotë partneriteti shkollë-familje-komunitet, ku ndërthuren mirë të gjashtë llojet e përfshirjes së prindërve.
- Drejtorët e shkollave në bashkëpunim me mësuesit, prindërit dhe nxënësit duhet të hartojnë programe të përfshirjes së prindërve dhe bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet, t'i zbatojnë, t'i monitorojnë dhe t'i rishikojnë ato së bashku në mënyrë të vazhdueshme. Nxënësve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, pasi roli i tyre është kyç në suksesin e këtyre programeve.
- Forcimi i komunikimit të dy-anshëm (shkollë-shtëpi-shkollë) është jetik për suksesin e përfshirjes së prindërve dhe bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet. Mësuesit duhet t'i kontaktojnë prindërit si kur fëmijët e tyre kanë probleme ashtu edhe kur ata kanë arritje pozitive.
- Drejtorët e shkollave dhe mësuesit duhet të mbështesin ngritjen e Këshillave të Prindërve të Shkollës dhe të Klasave përmes një procesi demokratik përzgjedhjeje, që inkurajon pjesëmarrjen e të gjithë prindërve dhe siguron mundësi të barabarta për të gjithë që të zgjidhen dhe të zgjedhin, pavarësisht nga niveli i arsimit apo statusit socio-ekonomik të familjes.
- Krijimi i Dhomës/Këndit të Prindërve dhe organizimi i aktiviteteve gjithëpërfshirëse si “Dita e Kthimit në Shkollë” dhe “Dita e Prindërve” mund të thyhejnë barrierat në pjesëmarrjen e prindërve të përjashtuar nga ana sociale duke i bërë ata të ndihen të mirëpritur dhe pjesë e rëndësishme e komunitetit të shkollës

### III. Në nivel komuniteti:

- Drejtuesit e pushtetit vendor dhe anëtarët e komunitetit dhe biznesit duhet të ofrojnë kontributin dhe resurset e tyre për krijimin e një ambjenti të favorshëm për forcimin e bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet dhe për arsimimin, mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve.

## Bibliografia

1. Epstein, J. L. (2001). *School, Family, and Community Partnerships: Preparing Educators and Improving Schools*. Westview Press, A Member of the Perseus Books Group
2. Grossman, S. (1999). *Examining the Origins of our Beliefs about Parents*. *Childhood Education*. v. 76 no 1.
3. Tichenor, M. S. (1998). *Preservice Teachers' Attitudes Toward Parent Involvement: Implications for Teacher Education*. *The Teacher Educator* v. 33 no 4.
4. Epstein, J. L., and S. L. Dauber. (1989). *Teacher attitudes and practices of parent involvement in inner-city elementary and middle schools*. CREMS Report No 32. Baltimore: John Hopkins University, Center for Research in Elementary and Middle Schools.
5. Becker, H. J., and J. L. Epstein. (1982). *Parent Involvement: A study of teacher practices*. *Elementary School Journal*
6. Hoxhallari, R. *Teachers' Beliefs and Practices of Parent Involvement (MSU/USA one school based research study, 2003)*
7. *Strategjia Kombetare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013*, Tiranë, Korrik 2009.
8. *Parent Involvement in the School Life - Albania Study Report, funded by the Education Support Program of Open Society Foundations*
9. *Advancing Education Quality and Inclusion in the South East Europe Project document*

REKOMANDIME PËR RRITJEN E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE NË ARSIM

# Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës

MA FATMIR BEZATI  
MA ROZETA HOXHALLARI